



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.74/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj - kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK) me seli në Prizren për shkak mospërputhjes së rezultateve sipas komuniteteve në komuna në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 28 dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë **03.02.2026**, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZP.Anr.74/2026, të datës 02.02.2026, parashtruar nga subjektit politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren paraqitur kundër vendimit të KQZ për shpalljen e rezultateve përfundimtare, për shkak mospërputhjes së rezultateve sipas komuniteteve në komuna në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 28 dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 02.02.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën ZP.Anr.74/2026 nga subjektit politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë. Në të cilën pretendohet se gjatë procesit zgjedhor të mbajtur me datë 28.12.2025 janë evidentuar mospërputhje serioze ndërmjet rezultateve zyrtare dhe realiteti demografik në disa komuna dhe vendvotime, ku këto rrethana kanë krijuar dyshime të bazuara dhe të arsyetuara për integritetin e procesit zgjedhor dhe përfaqësimin autentik të komunitetit. Më tutje në ankesë pretendohet se numërimi i të gjitha votave në nivel vendi në QKN ka dëshmuar parregullsitë më të mëdha të evidentuara të mospërputhjeve serioze të lartcekura dhe ky fakt e bën të nevojshëm edhe hetimin e burimit të votave. Në vazhdim sipas subjektit politik PREBK, në bazë të analizës së të dhënave të publikuara nga KQZ-ja dhe statistikave komunale, si dhe numrit të popullsisë së komunitetit rom në komuna specifike ku nuk jeton komuniteti rom, ka konstatuar se rezultatet në disa zona nuk pasqyrojnë vullnetin e vërtetë të komunitetit rom. Më tutje pretendohet se nga analiza e rezultateve zgjedhore, në raport me të dhënat demografike zyrtare, rezulton qartë se

ka pasur vota të orkestruara për subjekte të caktuara, të cilat janë siguruar nga votues që nuk i përkasin komunitetit rom dhe ky fakt vërtetohet përmes disproporcionit të theksuar ndërmjet numrit real të banorëve të komunitetit rom dhe numrit të votave të fituara në komuna ku ky komunitet është minimal ose nuk ka shënuar rritje domethënëse që nga zgjedhjet e shkurtit. Sipas parashtruesit të ankesës për herë të parë në zgjedhjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës, Subjekti politik Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës ka marrë vota në zona ku ka shumë pak ose aspak komunitet rom, ku është e përfshirë (në anëxin B) dhe njëkohësisht, ekziston një mospërputhje serioze ndërmjet numrit të votave që kandidatët e këtij subjekti kanë marrë në vendlindjet e tyre, ku rezultojnë rreth 40 vota në Prizren dhe numrit shumë më të madh të votave të marra në komunat të tjera, ku shënohen rreth 300 vota për kandidat ku mund të shihni (rezultatet e kandidateve të LPRK-se në faqen zyrtare të KQZ-së), si dhe ky fenomen përbën një rast unik dhe ngre dyshime serioze mbi përputhshmërinë e këtyre rezultateve me realitetin demografik dhe me vullnetin real të votuesve. Pretenduesi ankesës thekson se tendenca e krijimit të praktikave të tilla të votimit masiv nga një komunitet për subjektin e një komuniteti tjetër paraqet rrezik serioz sistemik, pasi në të ardhmen mund të shfrytëzohet nga komuniteti shumicë për t'ua pamundësuar komuniteteve pakicë ushtrimin real të së drejtës për përfaqësim objektiv.

Në vazhdim të ankesës është pretenduar se ka pasur mospërputhje ndërmjet numrit të votave dhe përbërjes demografike dyshime për orkestrimin dhe orientimin e votës, ku në disa komuna numri i votave për subjektet e komunitetit rom tejkalon dukshëm numrin zyrtar të banorëve të këtij komuniteti dhe në një numër të konsiderueshëm komunash, ku nuk ka pothuajse fare prani të komunitetit rom, janë regjistruar dhjetëra apo qindra vota për kandidatët e tij. Në ankesë pretenduesi ka përfshi disa shembuj të rezultateve sipas komunave si psh. Në Komunën e Deçanit, sipas të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) janë të regjistruar gjithsej 36 banorë të komunitetit rom. Megjithatë, nga rezultatet zgjedhore rezulton se subjekti politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës-PREBK ka marrë 3 vota, ndërsa subjekti politik LPRK 15 vota, çka paraqet një disproporcion të dukshëm në raport me numrin real të komunitetit rom në këtë komunë. Në Komunën e Glllogocit, sipas ASK-së, nuk, rezulton asnjë banor i komunitetit rom, megjithatë subjekti politik PREBK ka marrë 5 vota, ndërsa LPRK 14 vota, situatë kjo që ngrit dyshime serioze mbi burimin dhe ligjshmërinë e këtyre votave. Në Komunën e Dragashit, ku sipas sipas ASK-së, nuk ka banorë të komunitetit rom, rezulton se subjekti politik PREBK, ka marrë 1 votë, ndërsa LPRK 7 vota, çka paraqet një mospërputhje të qartë me të dhënat zyrtare statistikore. Në Komunën e Kaçanikut, sipas ASK-së janë të regjistruar 5 banorë të komunitetit rom, ndërsa subjekti politik PREBK ka marrë 2 vota dhe LPRK 22 vota, një numër dukshëm më i lartë se popullsia reale e komunitetit përkatës. Në Komunën e Leposaviqit, sipas ASK-së nuk rezulton popullsi rome, megjithatë të dy subjektet, PREBK dhe LPRK, kanë marrë nga 2 vota secili. Në Komunën e Prishtinës, sipas ASK-së janë të regjistruar 57 banorë të komunitetit rom, ndërsa nga rezultatet zgjedhore rezulton se subjekti politik PREBK ka marrë 12 vota, ndërsa LPRK 104 vota, çka tejkalon dukshëm numrin real të komunitetit rom në këtë komunë. Në Komunën e Skenderajt, sipas ASK-së janë të regjistruar 2 banorë të komunitetit rom, ndërsa subjekti politik PREBK ka marrë 7 vota dhe LPRK 11 vota, situatë kjo që paraqet disproporcion të theksuar. Në Komunën e Shtimes, sipas ASK-së janë të

regjistruar 17 banorë të komunitetit rom, ndërsa subjekti politik PREBK ka marrë 9 vota dhe LPRK 13 vota, çka përsëri tejkalon numrin real të komunitetit. Në Komunën e Vitisë, ku sipas ASK-së nuk ka banorë të komunitetit rom, rezulton se subjekti politik PREBK ka marrë 2 vota, ndërsa LPRK 16 vota. Në Komunën e Zveçanit, sipas ASK-së nuk, rezulton popullsi rome, megjithatë LPRK ka marrë 1 votë, ndërsa subjekti politik PREBK asnjë votë. Në Komunën e Malishevës, sipas ASK-së janë të regjistruar 28 banorë të komunitetit rom, ndërsa subjekti politik PREBK ka marrë 1 votë dhe LPRK 23 vota, çka paraqet një disproportcion të konsiderueshëm. Në Komunën e Junikut, sipas ASK-së nuk ka banorë të komunitetit rom, megjithatë LPRK ka marrë 2 vota, ndërsa subjekti politik PREBK asnjë votë. Në Komunën e Hanit të Elezit, sipas ASK-së nuk rezulton popullsi rome, ndërsa LPRK ka marrë 4 vota, dhe PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS-PREBK asnjë votë. Në Komunën e Kllkotit, sipas ASK-së të regjistruar 5 banorë të komunitetit rom, ndërsa LPRK ka marrë 4 vota, dhe subjekti politik PREBK asnjë votë. Në Komunën e Ferizajt, sipas ASK-së janë të regjistruar 218 banorë të komunitetit rom, ndërsa subjekti politik PREBK ka marrë 20 vota dhe LPRK 62 vota, çka paraqet një rritje të ndjeshme të votave për LPRK në raport me subjektin tjetër. Në Komunën e Vushtrrisë, sipas ASK-së të regjistruar 129 banorë të komunitetit rom, ndërsa subjekti politik PREBK ka marrë 2 vota, ndërsa LPRK 36 vota. Në Komunën e Suharekës, sipas ASK-së janë të regjistruar 126 banorë të komunitetit rom, ndërsa subjekti politik PREBK ka marrë 21 vota dhe LPRK 27 vota dhe në Komunën e Podujevës, sipas të dhënave zyrtare të ASK-së, janë të regjistruar gjithsej 56 banorë të komunitetit rom si dhe nga rezultatet zgjedhore rezulton se subjekti politik PREBK ka marrë 21 vota, ndërsa subjekti politik LPRK 46 vota. Më tutje pretenduesi i ankesës në ankesë ka përfshirë, vendimet e mëparshme lidhur me rastet Hodžić dhe Romani Iniciativa, PZAP (Vendimi nrAnr.656/2021) dhe Gjykata Supreme (Anr 30/2021) kanë konstatuar se votat e orientuara në mënyrë artificiale dhe të mbledhura në zona pa prani reale të komunitetit ku përbëjnë shkelje serioze të integritetit zgjedhor. Gjykata kishte nënvizuar faktin se nga provat në shkresat e lëndës është provuar se numri i votave të fituara nga subjekti politik Ujedinjina Zajednica — Adrijana Hodžić, nuk përputhet me numrin e votuesve të komunitetit për të cilin ka konkurruar përfaqësues në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më 14 shkurt 2021, në Komuna të caktuara dhe i kishte anuluar 2276 fletëvotime, Gjykata Supreme e Kosovës, në Aktgjykimin Anr 30/2021. Sipas këtij kontekst, PREBK, si subjekt ankues, kërkon shqyrtimin e plotë të kësaj ankese, verifikimin e rrethanave të orkestrimit të votave dhe gabimeve të votuesve, anulimin e pjesshëm të votave të kontestuar që nuk përputhen me realitetin demografik dhe që nuk kanë lidhje objektive votues—subjekt, si dhe ruajtjen dhe garantimin e së drejtës së përfaqësimit të komunitetit rom në përpjesëtim me numrin real të popullsisë dhe kërkon nga PZAP:

Të konstatojë shkeljet serioze të procesit zgjedhor konform mandatit ligjor, Të hetohet burimi i të subjektit politik LPRK, Të shpallë të pavlefshme votat e subjekteve politike LPRK dhe PREBK, si dhe të kandidatëve të komunitetit përkatës në komunat e kontestuar, ku nuk përputhet numri demografik i pjesëtarëve të komunitetit rom me votat e fituara, dhe jo vetëm për subjektin politik LPRK, por për secilin subjekt pa dallim, duke përfshirë edhe dy subjekte tjera garuese rome në zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025, siç janë: PREBK dhe KNRP, të anulojë mandatin e fituar në mënyrë jo legjitime, nëse konstatohen shkelje sistematike dhe të

orkestruara, të marrë çdo masë tjetër ligjore në funksion të ruajtjes së integritetit zgjedhor dhe përfaqësimit demokratik dhe kushtetues dhe të merren masa parandaluese që në të ardhmen kjo dukuri të mos përsëritet. Parashtruesi i ankesës në ankesë ka përfshi Aneksi A Tabela Krahimore e Agjencisë së Statistikave të Kosovës mbi numrin e komunitetit rom sipas komunave dhe votave të subjekteve politike të komunitetit rom në komunat përkatëse dhe Aneksi B — Krahimi i votave të subjekteve politike rrom 9 shkurt 2025 vs 28 dhjetor 2025.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja se sa i përket pretendimet e palës ankuese se rezultatet zgjedhore në komuna të caktuara nuk përputhen me strukturën demografike të popullsisë nuk përbëjnë bazë juridike për shpalljen e pavlefshme të votave. Lista Votuese nuk përmban dhe nuk mund të përmbajë të dhëna për përkatësinë etnike të votuesve si dhe KQZ nuk mbledh, nuk ruan dhe nuk përpunon të dhëna mbi etnicitetin e qytetarëve gjatë administrimit të procesit zgjedhor. Më tutje, theksohet se Rregullorja Zgjedhore nr. 03/2024 për krijimin, kundërshtimin dhe konfirmimin e listës së votuesve përcakton qartë se të dhënat që përfshihen në listë janë identifikuese dhe administrative, si emri, mbiemri, numri personal i identifikimit, data e lindjes dhe adresa, por jo përkatësia etnike. Përkatësisht, te neni 3 i Rregullores Zgjedhore nr. 03/2024 për Krijimin, Kundërshtimin dhe Konfirmimin e Listës Së Votuesve, parashihet procesi i krijimit të listës së votuesve ku paragrafi 1 i nenit 3 thekson se: KQZ mban LV dhe siguron që e njëjta bazohet në të dhënat e sakta, të përditësuara dhe më të fundit të Regjistrit Qendror Civil (RQC), dhe në mënyrë sistematike largon nga lista personat e vdekur dhe personat që kanë hequr dorë nga shtetësia. Kërkesa e palës ankuese për shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve nuk qëndron, për shkak se ajo duhet të jetë e bazuar dhe të ketë mbështetje ligjore, e as nuk mund të shpallet fletëvotimi i pavlefshëm në bazë të përkatësisë etnike të votuesit, Rastet e shpalljes së fletëvotimit të pavlefshëm parashihen në paragrafin 2.2 të nenit 16 të Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit. Sipas përgjigjes së KQZ-së, në rastin konkret, ankesa nuk identifikon manipulim të fletëvotimeve, ndërhyrje në kuti votimi, cenim të zinxhirit të sigurisë apo shkelje të procedurave të numërimit, por ajo mbështetet në interpretime statistikore të rezultatit zgjedhor. Në vazhdim theksohet se statistika nuk përbën provë juridike të parregullsisë zgjedhore, pranimi i një logjike të tillë do të nënkuptonte vlerësimin e votave mbi bazë të pritshmërisë demografike dhe jo mbi bazë të rregullsisë procedurale, gjë që do të minonte parimin e sigurisë juridike dhe stabilitetin e rezultatit zgjedhor, ku në këto rrethana, KQZ vlerëson se ankesa nuk mbështetet në bazë juridike dhe nuk demonstroi shkelje të procesit zgjedhor. Rezultati zgjedhor është produkt i votës së lirë dhe të fshehtë të qytetarëve dhe si i tillë gëzon mbrojtje kushtetuese.

Në përgjigjen nga subjekti politik LPRK pretendohet se ankuesi dështon të ofrojë dëshmi për “orkestrim”, dhe sipas standardeve ndërkombëtare zgjedhore, orkestrimi nënkupton një veprimtari të organizuar korruptive që përfshin, marrëveshje paraprake, provë për marrëveshje mes dy subjekteve për transferim votash, veprime mekanike: dëshmi për blerje votash, presion apo manipulim fizik të fletëvotimeve, dhe rithekson se as KQZ, as vëzhguesit dhe asnjë organ kompetent nuk ka raportuar asnjë parregullsi të tillë dhe votat e tyre janë rezultat i vullnetit të lirë, të fshehtë dhe sovran të qytetarëve. Në vazhdim të përgjigjes theksohet se pretendimi i PREBK se rezultatet e tyre është fenomen unik është i pavërtetë dhe siç dëshmohet nga listat

zyrtare të rezultateve të KQZ-së: Viti 2021: LPRK ka fituar në pothuajse identik votash në komunat e kontestuara dhe Viti 2025: Rezultatet tregojnë një stabilitet dhe rritje organike të elektoratit të tyre. Sipas subjektit politik LPRK për shkak të mungesës së fakteve dhe në dritën e Aktgjykimit K169/21, LPRK kërkon nga PZAP: të refuzojë ankesën e PREBK si të pabazuar, të konfirmohet vlefshmëria e plotë e votave të LPRK-së në të gjitha komunat dhe të mbrohet integriteti i votës së lirë dhe të mos lejohet që Llogaritë statistikore të përdoren si mjet për cenimin e mandateve demokratike.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi shqyrtimet ankimore, përgjigjen në ankesë, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli duke vlerësuar pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës, i cili pretendon se, ka pasur parregullsi në rezultatet zgjedhore në disa komuna ku nuk përputhen me strukturën demografike të popullsisë ku në bazë të analizës së të dhënave të publikuara nga KQZ-ja dhe statistikave komunale, si dhe numrit të popullsisë së komunitetit rom në komuna specifike ku nuk jeton komuniteti rom sipas rezultateve nuk pasqyrojnë vullnetin e vërtetë të komunitetit rom dhe se ka pasur vota të orkestruara për subjekte të caktuara dhe të cilat vota janë fituar nga votues të cilët janë të komunitetit tjetër në krahasim me komunitetin e subjektit për të cilin ka votuar, për Panelin këto pretendime janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga pretendimet e theksuara në ankesë paneli nuk ka arritur që të vërtetojë se ka pasur shkelje, parregullsi apo “orkestrime të votave” për të cilat pretendon pala ankuese në ankesën e parashtruar. Kjo pasi që ankuesi në ankesën e tij nuk i ka bashkangjitur asnjë provë të besueshme dhe nuk ka arritur ankesë të argumentoj pretendimet e tij dhe se këto pretendime tani për tani mbeten në suaza të supozimit

Sa i përket pretendimit ankimor me të cilin pretendohet se në disproporcion të plotë me numrin real të banorëve në komunitetin rom, pasi me votat e votuesve të komuniteteve të tjera është siguruar përfaqësimi politik i komunitetit rom, Paneli, vlerëson se, parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të saj nuk ka ofruar asnjë dëshmi dhe prova bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, kjo vërtetohet edhe nga përgjigja e KQZ-se e cila thekson se pretendimet e palës ankuese nuk qëndrojnë sepse në fletëvotim nuk mund të identifikohet emri i votuesit e as përkatësia etnike e votuesit dhe ankesa nuk identifikon manipulim të fletëvotimeve, nuk identifikohen ndërhyrje në kuti votimi, cenim të zingjirit të sigurisë apo shkelje të procedurave të numërimit, andaj bazuar në të gjitha këto Paneli ka vendosur që të refuzoj të pabazuar ankesën e ankuesit.

Lidhur me pretendimet e palës ankuese se gjatë procesit të votimit se në një numër të konsiderueshëm komunash, ku nuk ka komunitet rom dhe janë regjistruar dhjetëra apo qindra vota për subjektin LPRK dhe kandidatët e tij, Paneli vlerëson se sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Lista e votuesve nuk përmban të dhëna për komunitetet etnike në Kosovë, rrjedhimisht KQZ nuk bën grumbullim apo përpunim të dhënash për etnicitetin e

votuesve përkatësisht të votimit. Andaj për Panelin këto pretendime janë të pabazuara duke iu referuar nenit 6 par. 2 i LZP-së, që parasheh se "Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë", duke mos paragjykuar se si një votues zgjedhë të votojë një subjekt politik të caktuar".

Paneli sqaron se, për një situatë të tillë, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me Aktgjykimin në rastin K169/2021, në pikën 196 ka theksuar se: "..... në kuadër të sistemit aktual zgjedhor në Republikën e Kosovës nuk ka asnjë bazë mbi bazën e të cilës do të mund të shpallen të pavlefshme fletëvotime në vendvotime të caktuara duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve përfshirë proporcionin në mes numrit të fletëvotimeve që mund të ketë fituar një parti, koalicion, nismë qytetare dhe kandidat i pavarur që deklaroi që përfaqëson një komunitet dhe numrit të kalkuluar të votuesve të të njëjtit komunitet në vendvotime të caktuara. Gjykata rikujton që sipas GJENDJ-së (i) nuk është detyrë e gjykatave që të përcaktojnë vullnetin e votuesve, përfshirë përmes shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve pa bazë të saktë dhe (ii) çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar në bazë të saktë ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullativa e KQZ-së në kontekst të kompetencës së PZAP-së, për të anuluar/shpallur të pavlefshme fletëvotime." Ndërsa në pikën 198 të këtij aktgjykimi është konstatuar se: "Përfundimisht, Gjykata rithekson që vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe si e tillë nuk mund të anulohet/shpallet e pavlefshme bazuar në përkatësi etnike të votuesit."

Po ashtu paneli i është referuar dispozitës së nenit 45.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është paraparë që: "Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh që: "Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë." Në rastin konkret Paneli nuk mund të pranojë një pretendim dhe një kërkesë të tillë që të anulohen zgjedhjet dhe të shpallen të pavlefshme fletëvotimeve pa bazë të saktë ligjore, pasi që çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar dhe të ketë mbështetje ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe rregullativa e KQZ-së, për të anuluar zgjedhjet /dhe për të shpallur të pavlefshme fletëvotime.

Paneli rithekson që vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe si e tillë nuk mund të anulohet/shpallet e pavlefshme bazuar në përkatësi etnike të votuesit, sepse as Ligji dhe as Rregullativa e KQZ-së, nuk përcaktojnë asnjë kriter tjetër mbi bazën e të cilit mund të shpallen të pavlefshme fletëvotimet dhe aq më pak kriter të bazuar në përkatësi etnike të votuesve.

Paneli vlerësoi se ankesa e Partisë Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK) me seli në Prizren, është e pabazuar pasi që nuk ka bashkangjitur prova bindëse që do të dëshmonte pretendimet ankimore. Andaj duke u mbështetur në nenin 1 17.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse". Andaj, Paneli e refuzoi ankesën pasi që pala ankuese nuk e bëri të besueshme me prova bindëse dhe nuk ka mundur të

vërtetoj se votat për këtë komunitet respektivisht për subjektin politik PRBEK janë të manipuluar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZP.Anr.74/2026 më datën 03.02.2026

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas neni 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.6/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Faton Bajrami dhe Nenad Laziq, anëtarë, lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), për shkak të mospërputhjes së rezultateve sipas komuniteteve në komuna në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28.12.2025, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.74/2026, të datës 03.02.2026, në seancën e mbajtur më datë, 09.02.2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ZP.Anr.74/2026, të datës 03.02.2026.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa ZP.Anr.74/2026, të datës 03.02.2026, është vendosur: "Refuzohet e pabazuar ankesa ZP.Anr.74/2026, e datës 02.02.2026, e parashtruar nga subjekti politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të mospërputhjes së rezultateve sipas komuniteteve në komuna në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28.12.2025."

Kundër vendimit të lartpërmendur, e subjekti politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën i konteston rezultatet e përgjithshme të zgjedhjeve të parakohshme, gjegjësisht pretendon se gjatë procesit zgjedhor të mbajtur me datë 28.12.2025, janë evidentuar mospërputhje serioze ndërmjet rezultateve zyrtare dhe realiteti demografik në disa komuna dhe vendvotime, ku këto rrethana kanë krijuar dyshime të bazuara dhe të arsyetuara për integritetin e procesit zgjedhor dhe përfaqësimin autentik të komunitetit. Më tutje në ankesë pretendohet se numërimi i të gjitha votave në nivel vendi në QKN ka dëshmuar parregullsitë më të mëdha të evidentuara të mospërputhjeve serioze të lartcekura dhe ky fakt e bën të nevojshëm edhe hetimin e burimit të votave. Në vazhdim sipas subjektit politik PREBK, në bazë të analizës së të dhënave të



publikuara nga KQZ-ja dhe statistikave komunale, si dhe numrit të popullsisë së komunitetit rom në komuna specifike ku nuk jeton komuniteti rom, ka konstatuar se rezultatet në disa zona nuk pasqyrojnë vullnetin e vërtetë të komunitetit rom. Më tutje pretendohet se nga analiza e rezultateve zgjedhore, në raport me të dhënat demografike zyrtare, rezulton qartë se ka pasur vota të orkestruara për subjekte të caktuara, të cilat janë siguruar nga votues që nuk i përkasin komunitetit rom dhe ky fakt vërtetohet përmes disproporcionit të theksuar ndërmjet numrit real të banorëve të komunitetit rom dhe numrit të votave të fituara në komuna ku ky komunitet është minimal ose nuk ka shënuar rritje domethënëse që nga zgjedhjet e shkurtit. Si rrjedhojë, ka propozuar që Gjykata Supreme të aprovoj ankesën si të bazuar, të konstatojë shkeljet serioze të procesit zgjedhor konform mandatit ligjor, të hetohet burimi i të subjektit politik LPRK, të shpallë të pavlefshme votat e subjekteve politike LPRK dhe PREBK, si dhe të kandidatëve të komunitetit përkatës në komunat e kontestuar, ku nuk përputhet numri demografik i pjesëtarëve të komunitetit rom me votat e fituara, dhe jo vetëm për subjektin politik LPRK, por për secilin subjekt pa dallim, duke përfshirë edhe dy subjekte tjera garuese rome në zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025, siç janë: PREBK dhe KNRP, të anulojë mandatin e fituar në mënyrë jo legjitime, nëse konstatohen shkelje sistematike dhe të orkestruara, të marrë çdo masë tjetër ligjore në funksion të ruajtjes së integritetit zgjedhor dhe përfaqësimit demokratik dhe kushtetues dhe të merren masa parandaluese që në të ardhmen kjo dukuri të mos përsëritet.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjekti politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), me seli në Prizren, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e subjektit politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZP.A.nr.74/2026, datë 03.02.2026.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 02.02.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën ZP.Anr.74/2026 nga subjektit politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), në të cilën pretendohet se gjatë procesit zgjedhor të mbajtur me datë 28.12.2025 janë evidentuar mospërputhje serioze ndërmjet rezultateve zyrtare dhe realitetit demografik në disa komuna dhe vendvotime, ku këto rrethana kanë krijuar dyshime të bazuara dhe të arsyetuara për integritetin e procesit zgjedhor dhe përfaqësimin autentik të komunitetit. Më tutje në ankesë pretendohet se numërimi i të gjitha votave në nivel vendi në QKN ka dëshmuar parregullsitë më të mëdha të evidentuara të mospërputhjeve serioze të lartcekura dhe ky fakt e bën të nevojshëm edhe hetimin e burimit të votave. Në vazhdim sipas subjektit politik PREBK, në bazë të analizës së të dhënave të publikuara nga KQZ-ja dhe statistikave komunale, si dhe numrit të popullsisë së komunitetit rom në komuna specifike ku nuk jeton komuniteti rom, ka konstatuar se rezultatet në disa zona nuk pasqyrojnë vullnetin e vërtetë të komunitetit rom. Më tutje pretendohet se nga analiza e rezultateve zgjedhore, në raport me të dhënat demografike zyrtare, rezulton qartë se ka pasur vota të orkestruara për subjekte të caktuara, të cilat janë siguruar nga votues që nuk i përkasin komunitetit rom dhe ky fakt vërtetohet përmes



disproporcionit të theksuar ndërmjet numrit real të banorëve të komunitetit rom dhe numrit të votave të fituara në komuna ku ky komunitet është minimal ose nuk ka shënuar rritje domethënëse që nga zgjedhjet e shkurtit. Sipas parashtresës së ankesës për herë të parë në zgjedhjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës, Subjekti politik Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës ka marrë vota në zona ku ka shumë pak ose aspak komunitet rom, ku është e përfshirë (në anëxin B) dhe njëkohësisht, ekziston një mospërputhje serioze ndërmjet numrit të votave që kandidatët e këtij subjekti kanë marrë në vendlindjet e tyre, ku rezultojnë rreth 40 vota në Prizren dhe numrit shumë më të madh të votave të marra në komunat të tjera, ku shënohen rreth 300 vota për kandidat ku mund të shihni (rezultatet e kandidateve të LPRK-së në fagen zyrtare të KQZ-së), si dhe ky fenomen përbën një rast unik dhe ngre dyshime serioze mbi përputhshmërinë e këtyre rezultateve me realitetin demografik dhe me vullnetin real të votuesve. Pretenduesi ankesës thekson se tendenca e krijimit të praktikave të tilla të votimit masiv nga një komunitet për subjektin e një komuniteti tjetër paraqet rrezik serioz sistematik, pasi në të ardhmen mund të shfrytëzohet nga komuniteti shumicë për t'ua pamundësuar komuniteteve pakicë ushtrimin real të së drejtës për përfaqësim objektiv (më gjerësisht sikurse në ankesën e parashtuar).

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja ka theksuar se, sa i përket pretendimeve të palës ankuese se rezultatet zgjedhore në komuna të caktuara nuk përputhen me strukturën demografike të popullsisë nuk përbëjnë bazë juridike për shpalljen e pavlefshme të votave. Lista Votuese nuk përmban dhe nuk mund të përmbajë të dhëna për përkatësinë etnike të votuesve si dhe KQZ nuk mbledh, nuk ruan dhe nuk përpunon të dhëna mbi etnicitetin e qytetarëve gjatë administrimit të procesit zgjedhor. Më tutje, theksohet se Rregullorja Zgjedhore nr. 03/2024 për krijimin, kundërshtimin dhe konfirmimin e listës së votuesve përcakton qartë se të dhënat që përfshihen në listë janë identifikuese dhe administrative, si emri, mbiemri, numri personal i identifikimit, data e lindjes dhe adresa, por jo përkatësia etnike. Përkatësisht, te neni 3 i Rregullores Zgjedhore nr. 03/2024 për Krijimin, Kundërshtimin dhe Konfirmimin e Listës Së Votuesve, parashihet procesi i krijimit të listës së votuesve ku paragrafi 1 i nenit 3 thekson se: KQZ mban LV dhe siguron që e njëjta bazohet në të dhënat e sakta, të përditësuara dhe më të fundit të Regjistrit Qendror Civil (RQC), dhe në mënyrë sistematike largon nga lista personat e vdekur dhe personat që kanë hequr dorë nga shtetësia. Kërkesa e palës ankuese për shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve nuk qëndron, për shkak se ajo duhet të jetë e bazuar dhe të ketë mbështetje ligjore, e as nuk mund të shpallet fletëvotimi i pavlefshëm në bazë të përkatësisë etnike të votuesit, Rastet e shpalljes së fletëvotimit të pavlefshëm parashihen në paragrafin 2.2 të nenit 16 të Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit. Sipas përgjigjes së KQZ-së, në rastin konkret, ankesa nuk identifikon manipulim të fletëvotimeve, ndërhyrje në kuti votimi, cenim të zinxhirit të sigurisë apo shkelje të procedurave të numërimit, por ajo mbështetet në interpretime statistikore të rezultatit zgjedhor. Në vazhdim theksohet se statistika nuk përbën provë juridike të parregullsisë zgjedhore, pranimi i një logjike të tillë do të nënkuptonte vlerësimin e votave mbi bazë të pritshmërisë demografike dhe jo mbi bazë të rregullsisë procedurale, gjë që do të minonte parimin e sigurisë juridike dhe stabilitetin e rezultatit zgjedhor, ku në këto rrethana, KQZ vlerëson se ankesa nuk mbështetet në bazë juridike dhe nuk demonstroi shkelje të procesit zgjedhor. Rezultati zgjedhor është produkt i votës së lirë dhe të fshhtë të qytetarëve dhe si i tillë gëzon mbrojtje kushtetuese.



Në përgjigjen nga subjekti politik LPRK pretendohet se ankuesi dështon të ofrojë dëshmi për "orkestrim", dhe sipas standardeve ndërkombëtare zgjedhore, orkestrimi nënkupton një veprimtari të organizuar korruptive që përfshin, marrëveshje paraprake, provë për marrëveshje mes dy subjekteve për transferim votash, veprime mekanike: dëshmi për blerje votash, presion apo manipulim fizik të fletëvotimeve, dhe rithekson se as KQZ, as vëzhguesit dhe asnjë organ kompetent nuk ka raportuar asnjë parregullsi të tillë dhe votat e tyre janë rezultat i vullnetit të lirë, të fshehtë dhe sovran të qytetarëve. Në vazhdim të përgjigjes theksohet se pretendimi i PREBK se rezultatet e tyre është fenomen unik është i pavërtetë dhe siç dëshmohet nga listat zyrtare të rezultateve të KQZ-së: Viti 2021: LPRK ka fituar numër pothuajse identik votash në komunat e kontestuara dhe Viti 2025: Rezultatet tregojnë një stabilitet dhe rritje organike të elektoratit të tyre. Sipas subjektit politik LPRK për shkak të mungesës së fakteve dhe në dritën e Aktgjykimit K169/21, LPRK kërkon nga PZAP: të refuzojë ankesën e PREBK si të pabazuar, të konfirmohet vlefshmëria e plotë e votave të LPRK-së në të gjitha komunat dhe të mbrohet integriteti i votës së lirë dhe të mos lejohet që Llogaritë statistikore të përdoren si mjet për cenimin e mandateve demokratike.

PZAP, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, ankesën në fjalë, gjeti se e njëjta është e pabazuar. Më tutje, Paneli duke vlerësuar pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës, i cili pretendon se, ka pasur parregullsi në rezultatet zgjedhore në disa komuna ku nuk përputhen me strukturën demografike të popullsisë ku në bazë të analizës së të dhënave të publikuara nga KQZ-ja dhe statistikave komunale, si dhe numrit të popullsisë së komunitetit rom në komuna specifike ku nuk jeton komuniteti rom sipas rezultateve nuk pasqyrojnë vullnetin e vërtetë të komunitetit rom dhe se ka pasur vota të orkestruara për subjekte të caktuara dhe të cilat vota janë fituar nga votues të cilët janë të komunitetit tjetër në krahasim me komunitetin e subjektit për të cilin ka votuar, për Panelin këto pretendime janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga pretendimet e theksuara në ankesë paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje, parregullsi apo "orkestrime të votave" për të cilat pretendon pala ankuese në ankesën e parashtruar. Kjo pasi që ankuesi në ankesën e tij nuk i ka bashkangjitur asnjë provë të besueshme dhe nuk ka arritur ankesë të argumentoj pretendimet e tij dhe se këto pretendime tani për tani mbeten në suaza të supozimit.

Sa i përket pretendimit ankimor me të cilin pretendohet se në disproporcion të plotë me numrin real të banorëve në komunitetin rom, pasi me votat e votuesve të komuniteteve të tjera është siguruar përfaqësimi politik i komunitetit rom, Paneli, vlerëson se, parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të saj nuk ka ofruar asnjë dëshmi dhe prova bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, kjo vërtetohet edhe nga përgjigja e KQZ-se e cila thekson se pretendimet e palës ankuese nuk qëndrojnë sepse në fletëvotim nuk mund të identifikohet emri i votuesit e as përkatësia etnike e votuesit dhe ankesa nuk identifikon manipulim të fletëvotimeve, nuk identifikohen ndërhyrje në kuti votimi, cenim të zingjirit të sigurisë apo shkelje të procedurave të numërimit, andaj bazuar në të gjitha këto Paneli ka vendosur që të refuzoj të pabazuar ankesën e ankuesit.



Lidhur me pretendimet e palës ankuese se gjatë procesit të votimit se në një numër të konsiderueshëm komunash, ku nuk ka komunitet rom dhe janë regjistruar dhjetëra apo qindra vota për subjektin LPRK dhe kandidatët e tij, Paneli vlerëson se sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Lista e votuesve nuk përmban të dhëna për komunitetet etnike në Kosovë, rrjedhimisht KQZ nuk bën grumbullim apo përpunim të dhënash për etnicitetin e votuesve votimit. Andaj për Panelin këto pretendime janë të pabazuara duke iu referuar nenit 6 par. 2 i LZP-së, që parasheh se "Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë", duke mos paragjykuar se si një votues zgjedhë të votojë një subjekt politik të caktuar".

Paneli sqaroi se, për një situatë të tillë, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me Aktgjykimin në rastin K169/2021, në pikën 196 ka theksuar se: "... në kuadër të sistemit aktual zgjedhor në Republikën e Kosovës nuk ka asnjë bazë mbi bazën e të cilës do të mund të shpallen të pavlefshme fletëvotime në vendvotime të caktuara duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve përfshirë proporcionin në mes numrit të fletëvotimeve që mund të ketë fituar një parti, koalicion, nismë qytetare dhe kandidat i pavarur që deklaron që përfaqëson një komunitet dhe numrit të kalkuluar të votuesve të të njëjtit komunitet në vendvotime të caktuara. Gjykata rikujton që sipas GJENDJ-së (i) nuk është detyrë e gjykatave që të përcaktojnë vullnetin e votuesve, përfshirë përmes shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve pa bazë të saktë dhe (ii) çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar në bazë të saktë ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullativa e KQZ-së në kontekst të kompetencës së PZAP-së, për të anuluar/shpallur të pavlefshme fletëvotime." Ndërsa në pikën 198 të këtij aktgjykimi është konstatuar se: "Përfundimisht, Gjykata rithekson që vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe si e tillë nuk mund të anulohet/shpallet e pavlefshme bazuar në përkatësi etnike të votuesit." Po ashtu paneli i është referuar dispozitës se nenit 45.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është paraparë që: "Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh që: "Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë." Në rastin konkret Paneli nuk mund të pranojë një pretendim dhe një kërkesë të tillë që të anulohen zgjedhjet dhe të shpallen të pavlefshme fletëvotimeve pa bazë të saktë ligjore, pasi që çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar dhe të ketë mbështetje ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe rregullativa e KQZ-së, për të anuluar zgjedhjet /dhe për të shpallur të pavlefshme fletëvotime.

Paneli rithekson që vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe si e tillë nuk mund të anulohet/shpallet e pavlefshme bazuar në përkatësi etnike të votuesit, sepse as Ligji dhe as Rregullativa e KQZ-së, nuk përcaktojnë asnjë kriter tjetër mbi bazën e të cilit mund të shpallen të pavlefshme fletëvotimet dhe aq më pak kriter të bazuar në përkatësi etnike të votuesve. Paneli vlerësoi se ankesa e Partisë Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK) me seli në Prizren, është e pabazuar pasi që nuk ka bashkangjitur prova bindëse që do të dëshmonte pretendimet ankimore. Andaj, duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta



dhe bindëse”. Andaj, Paneli e refuzoi ankesën pasi që pala ankuese nuk e bëri të besueshme me prova bindëse dhe nuk ka mundur të vërtetoj se votat për këtë subjekt janë të manipuluar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me refuzimin e ankesës së subjektit politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), për shkak të mospërputhjes së rezultateve sipas komuniteteve në komuna në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28.12.2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Nga kjo rezulton se shkeljet e pretenduara në ankesë se gjatë procesit zgjedhor të mbajtur me datë 28.12.2025, janë evidentuar mospërputhje serioze ndërmjet rezultateve zyrtare dhe realiteti demografik në disa komuna dhe vendvotime, ku këto rrethana kanë krijuar dyshime të bazuara dhe të arsyetuara për integritetin e procesit zgjedhor dhe përfaqësimin autentik të komunitetit, nga kolegji i Gjykatës Supreme vlerësohen të pabazuara. Meqenëse ankuesi në ankesën e paraqitur nuk i është referuar shkeljeve konkrete të dispozitave të procedurës ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, por vetëm çështjeve që kanë të bëjnë me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale, Gjykata Supreme është kufizuar vetëm në trajtimin e këtyre pretendimeve ankimore.

Si rrjedhojë, objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme ishin pretendimet ankimore të ankuesit, përkitazi me rezultatet e përgjithshme të zgjedhjeve, respektivisht mospërputhjet serioze ndërmjet rezultateve zyrtare dhe realiteti demografik në disa komuna dhe vendvotime, mirëpo këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate refuzohen si të pabazuara dhe jo të qëndrueshme. Kjo për faktin se PZAP, me rastin e refuzimit të ankesës së ankuesit, si në vendimin e atakuar, me të drejtë ka vlerësuar se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme, për faktin se nga pretendimet e theksuara në ankesë paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje, parregullsi apo "orkestrime të votave" për të cilat pretendon pala ankuese në ankesën e parashtuar. Si rrjedhojë, të njëjtat pretendime, nga provat e ofruara nga ana e parashtuesit të ankesës në Gjykatën Supreme, nuk janë vërtetuar këto pretendime.

Nga kjo rrjedh se është i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i PZAP, se nuk qëndron pretendimi ankimor i ankuesit se votat janë në disproporcion të plotë me numrin real të banorëve në komunitetin rom, pasi me votat e votuesve të komuniteteve të tjera është siguruar përfaqësimi politik i komunitetit rom. Kjo për faktin se ankuesi në mbështetje të pretendimeve të tij nuk ka ofruar asnjë dëshmi dhe prova bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin. Përveç kësaj është i drejtë edhe i ligjshëm konstatimi i PZAP-it se në rastin konkret, një gjendje e tillë faktike vërtetohet edhe nga përgjigja e KQZ-se e cila ndër të tjera ka theksuar se pretendimet e palës ankuese nuk qëndrojnë, sepse në fletëvotim nuk mund të identifikohet emri i votuesit e as përkatësia etnike e votuesit dhe ankesa nuk identifikon manipulim të fletëvotimeve, nuk



identifikohen ndërhyrje në kuti votimi, cenim të zingjirit të sigurisë apo shkelje të procedurave të numërimit. Në anën tjetër, edhe për kolegjin e kësaj gjykate është i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i PZAP-it i dhënë lidhur me pretendimet e palës ankuese se gjatë procesit të votimit në një numër të konsiderueshëm komunash, ku nuk ka komunitet rom dhe janë regjistruar dhjetëra apo qindra vota për subjektin LPRK dhe kandidatët e tij. Kjo për faktin se është i drejtë konstatimi dhe vlerësimi i PZAP-it, se referuar Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Lista e votuesve nuk përmban të dhëna për komunitetet etnike në Kosovë, rrjedhimisht KQZ nuk bën grumbullim apo përpunim të dhënash për etnicitetin e votuesve. Si rrjedhojë e kësaj, tani pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi për shkeljet e pretenduara si më lartë janë të pabazuara, pasi që referuar nenit 6 par. 2 i LZP-së, parashihet qartazi se: *"Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë", duke mos paragjykuar se si një votues zgjedhë të votojë një subjekt politik të caktuar*".

Kolegji i Gjykatës Supreme i vlerësoi edhe pretendimet e ankuesit, të cilat i referohen praktikës gjyqësore të mëparshme për situata të ngjashme, përkatësisht vendimmarrjes përmes aktgjykimit të Gjykatës Supreme A.nr.30/2021, të datës 11.03.2021, të cilit i është referuar ankuesi në ankesën e parashtruar, mirëpo erdhi në përfundim se të njëjtat janë të pabazuara. Kjo për faktin se, referuar shkresave të lëndës, përkatësisht vendimit të atakuar të PZAP-it, rezulton se ky i fundit për çështjen kontestuese me të drejtë i është referuar aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të datës 26.05.2023, në rastin nr.KI69/21 Parashtrues Partia Liberale Egjiptiane (PLE) dhe Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK). Në lidhje me këtë, përkatësisht për çështjet e ngritura me ankesë nga këtu ankuesi, Gjykata Kushtetuese në pikën 196 të këtij aktgjykimi, ka theksuar se: "... në kuadër të sistemit aktual zgjedhor në Republikën e Kosovës nuk ka asnjë bazë mbi bazën e të cilës do të mund të shpallen të pavlefshme fletëvotime në vendvotime të caktuara duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve përfshirë proporcionin në mes numrit të fletëvotimeve që mund të ketë fituar një parti, koalicion, nismë qytetare dhe kandidat i pavarur që deklaron që përfaqëson një komunitet dhe numrit të kalkuluar të votuesve të të njëjtit komunitet në vendvotime të caktuara. Gjykata rikujton që sipas GJENDJ-së (i) nuk është detyrë e gjykatave që të përcaktojnë vullnetin e votuesve, përfshirë përmes shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve pa bazë të saktë dhe (ii) çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar në bazë të saktë ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullativa e KQZ-së në kontekst të kompetencës së PZAP-së, për të anuluar/shpallur të pavlefshme fletëvotime." Ndërsa në pikën 198 të këtij aktgjykimi është konstatuar se: "Përfundimisht, Gjykata rithekson që vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe si e tillë nuk mund të anulohet/shpallet e pavlefshme bazuar në përkatësi etnike të votuesit."

Si rezultat i kësaj, si dhe për faktin se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, konform nenit 4 paragrafi 6, lidhur me nenin 112 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën, si dhe bazuar në nenin 116 paragrafi 1, të kushtetutës ku shprehimisht përcaktohet se: *"Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës"*, tani vendimmarrja e Gjykatës Supreme për çështjet e trajtuara nga Gjykata



Kushtetuese në aktgjykimin nr.KI69/21, të datës 26.05.2023, e të cilat edhe janë objekt i ankesës së ankuesit (të cilat kanë të bëjnë me kërkesën për shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve në vendvotime të caktuara, duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve), bëhet pikërisht në përputhje me këtë aktgjykim, përkatësisht me pikën 208, 209, 210 dhe 212 të tij.

Mbi këtë bazë, kolegji i Gjykatës Supreme i ka vlerësuar të pabazuara edhe pretendimet lidhur me atë se vendimi i PZAP është jo bindës dhe kontradiktorë, kjo për faktin se duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar nga PZAP, dhe dispozitave të lartcekura, vlerëson se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, nga çka rezulton se vendimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe me Rregulloren nr.01/2025, të Panelit Zgjedhor për Ankesat dhe Parashtresa (PZAP), dhe në mungesë të provave të qëndrueshme ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtresit të ankesës, prandaj, pretendimet ankimore janë refuzuar si të pabazuara. Kjo për faktin se si të tilla nuk dëshmuuan se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakte të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.6/2026, datë 09.02.2026

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE


Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS / SUBSKI SAVET KOSOVA / KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



SEKRETARINAT I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Shefi i shkresës
Oznaka spisa:

HA-6/2026

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLJANJE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e kësaj detyre të bëhet dorëzimi i sa pas lehtës së lajmërimit me shkronja që për shkak të dorëzimit të gjendjet në kohën e caktuar në bancesh apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë; anëtarit nadhor të familjes së marrësi - kujdestarit të ndërkësës, fqinjtë, personit që punon po në të vend me marrësin.

1. Posto pritëse, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gdje se dostavljanje ima izvršiti ni pošte ostavljenog pismenog obavještenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domaćin. Primaoca naslopniku zgrece susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtarit i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u të marrësi në vendin e punës së marrësi (duke e ngjitur në detyrë e bancesh ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto pritëse odnosno član njegov domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pibiteno na vratima stana odnosno prostorije gdje pritilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____ u _____ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijma _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTIVISTI

09.02.2026

Numri i shlojave: _____
broj priloga _____

Vërtetohet se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)
Povrdjeno prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

Priloga 09.02.2026

(Nënshkrimi i marrësi ose i anij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primaoca ili lica koje je
pismeno primilo u zaimenu)

15.11

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesit, duke shënuar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpise, potpisuje ga dostaljaoc, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.

Priloga